



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 391 / prot.

10

Tiranë, më 05.12.2023

VENDIM

Nr. 1034, Datë 05.12.2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM NGA SHOQËRIA CSIC LONGJIANG GH GAS TURBINE CO., LTD MBI ASETET E BIZNESIT TË TURBINAVE ME GAZ TË MAN ENERGY SOLUTIONS SE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.12.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm nga shoqëria CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co., Ltd mbi asetet e Biznesit të turbinave me gaz të MAN Energy Solutions SE.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm nga shoqëria CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co., Ltd mbi asetet e Biznesit të turbinave me gaz të MAN Energy Solutions SE,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfitim të kontrollit të vetëm nga shoqëria CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co., Ltd mbi asetet e Biznesit të turbinave me gaz të MAN Energy Solutions SE.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për shitjen dhe transferimin e biznesit të turbinës së gazit të MAN Energy Solutions SE dhe Filialeve”, palët në marrëveshje janë:

Blerësi 1: CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co., Ltd (GHGT) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit kinez, me objekt aktiviteti: kërkimi dhe zhvillimi, prodhimi dhe shitja e gazit të turbinave dhe pjesëve, projektimi, prodhimi, shitja, instalimi, komisioni, eksperimentimi, riparimi, mbështetja dhe shërbimi i pajisjeve dhe pajisjeve mbështetëse të turbinave me gaz.

Turbinat e gazit të prodhuara nga GHGT përqendrohen kryesisht në rangun e fuqisë mesatare prej 25-50 MV, të cilat përdoren për prodhimin e energjisë, disqet mekanike dhe teknologjinë në det të hapur.

GHGT është një filial i China State Shipbuilding Co. Ltd (CSSC), si një shoqëri aktive në prodhimin dhe shitjen e anijeve, etj. Aksionet e shoqërisë China State Shipbuilding Co. Ltd, zotërohen 100% nga Komisioni Kinez i Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Aseteve të Këshillit Shtetëror (SASAC), që është shoqëria mëmë përfundimtare e shoqërisë CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co., Ltd.

GHGT dhe CSSC nuk kanë gjeneruar të ardhura dhe nuk kanë prezencë ligjore në Shqipëri
Shoqëria Beralb SHA, e cila zotërohet nga shoqëria Nesko Metal Sanayive Ticaret Anonim Sirketi, një prej sipërmarrjeve të përbashkëta të Grupit, ka realizuar xhiro në Shqipëri për vitin 2022 nga aktiviteti në fushën minerare.

Blerësi 2: Guanghan Gas Turbine GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: zhvillimi, prodhimi, shitja, instalimi, mirëmbajtja e turbinave dhe komponentëve me gaz, pajisjeve të turbinave me gaz dhe pajisjeve shtesë të lidhura me to, si dhe shërbimet teknike përkatëse.

Blerësi 3: Guanghan Gas Turbine Schweiz AG është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose korporatë, e regjistruar sipas legjislacionit zvicerian, me objekt aktiviteti: zhvillimi, prodhimi, shitja, instalimi, mirëmbajtja e turbinave dhe komponentëve me gaz, pajisjeve të turbinave me gaz dhe pajisjeve shtesë të lidhura me to, si dhe shërbimet teknike përkatëse. Shoqëria mund të blejë, të mbajë dhe të shesë tokë brenda dhe jashtë vendit dhe të kryejë të gjitha aktivitetet e financimit, tregtimit dhe aktivitete të tjera që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e shoqërisë.

Shitësi 1: Man Energy Solutions SE është një shoqëri evropiane (SE) e listuar në bursë, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: zhvillimi, projektimi, prodhimi, shitja dhe shërbimi i makinerive dhe aparateve të të gjitha llojeve, në veçanti motorët me naftë të të gjitha llojeve dhe për të gjitha përdorimet, duke përfshirë motorët detarë dhe motorët për sisteme të palëvizshme, dhe turbomakineri e kompresorë, si dhe ofrimi i të gjitha shërbimeve të lidhura me to, duke përfshirë licencimin.

Man Energy Solutions SE kryen aktivitetin e Turbinave të gazit në lidhje me Serinë MGT, Serinë

THM, Serinë PT8 në ambientet e tij në Oberhausen, Gjermani, i cili përfshin fushat funksionale si vijon:

- Kërkim dhe Zhvillim (R&D) dhe inxhinierim për Serinë MGT dhe THM;
- Prodhim, Testim, Montim dhe Menaxhim i Zinxhirit të Furnizimit;
- Shërbimet pas shitjes për Serinë MGT, Serinë THM, Serinë PT8
- Shitjet dhe Ekzekutimi për Serinë MGT; dhe
- Administrata dhe funksionet e përgjithshme.

Shoqëria Man Energy Solutions SE është një filial i zotëruar në mënyrë indirekte nga Volkswagen Aktiengesellschaft, e cila është shoqëria mëmë e grupit Volkswagen.

Shitësi 2: MAN Energy Solutions Schweiz AG është një shoqëri publike, e regjistruar sipas legjislacionit zvicerian. Objekti i shoqërisë është si pjesë e grupit MAN Energy Solutions, në zhvillimin, projektimin, prodhimin, shitjen dhe shërbimin e Turbomakinerve, kompresorë dhe makineri të tjera si dhe dispozita me të gjitha shërbimet e lidhura, etj.

MAN Energy Solutions Schweiz AG drejton biznesin e turbinave me gaz në Zvicër që përfshin kryesisht inxhinierinë, shitjet, ekzekutimin dhe shërbimet për Serinë S.

Man Energy Solutions SE është aksioneri i vetëm dhe shoqëria mëmë e MAN Energy Solutions Schweiz AG.

Biznesi Target: Biznesi i turbinave me gaz përbëhet nga asetet materiale që i përkasin divizionit të turbinave me gaz të shoqërisë Man Energy Solutions SE, i cili prodhon dhe shpërndan turbina industriale me gaz të prodhuara si për prodhimin e energjisë ashtu edhe për aplikimin e lëvizjes mekanike. Biznesi është kryesisht aktiv në zhvillimin, prodhimin, shitjen, instalimin dhe vënien në punë të turbinave me gaz nga klientët si njësi lëvizëse për gjeneratorët e energjisë, turbokompresorët dhe pompat në klasën e fuqisë deri në 17.5 MW. Portofoli i tij i shërbimeve përfshin gjithashtu shërbimet pas shitjes.

“**Biznesi i shitur**” përfshin fusha funksionale si: (i) zhvillimi, kërkimi dhe dizenjimi, (ii) prodhimi, blerja, testimi, montimi dhe menaxhimi i shpërndarjes, (iii) shitjet dhe shërbimet pas shitjes. Biznesi i turbinave me gaz ka prodhuar katër seri turbinash me gaz në klasën e fuqisë nga 5.5 MV në 17.5 MV, pra seritë THM, PT8 dhe MGT. Seria MGT është seria e vetme ku po realizohet zhvillimi i mëtejshëm.

Divizioni i turbinave me gaz ndodhet në Gjermani, në Oberhausen si dhe në Zvicër

Biznesi i turbinave me gaz nuk ka patur prezencë ligjore dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri gjatë vitit 2022.

II. Përqendrimi

Më datë _____, është lidhur “Marrëveshje për shitjen dhe transferimin e biznesit të turbinës së gazit të MAN Energy Solutions SE dhe Filialeve”, ndërmjet shoqërive Man Energy Solutions SE në cilësinë e shitësit 1, MAN Energy Solutions Schweiz AG në cilësinë e shitësit 2, dhe CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co.,Ltd, në cilësinë e blerësit 1, Guanghan Gas Turbine GmbH, në cilësinë e blerësit 2, dhe Guanghan Gas Turbine Schweiz AG në cilësinë e blerësit 3.

Referuar “Marrëveshjes për shitjen dhe transferimin e biznesit të turbinës së gazit të MAN Energy Solutions SE dhe Filialeve”, shitësit synojnë të shesin dhe transferojnë te blerësit dhe blerësit synojnë të blejnë aktive të caktuara që i përkasin biznesit të turbinave me gaz të operuar nga shitësit, duke përfshirë biznesin pas shitjes si vazhdimësi duke blerë dhe marrë përsipër asete individuale dhe duke marrë përsipër detyrime të caktuara, kontrata pune dhe marrëdhënie kontraktuale (Transaksioni) duke lidhur këtë marrëveshje të blerjes së aseteve (Marrëveshja).

Biznesi i turbinave me gaz të shitësve dhe filialeve të tyre, përfshin zhvillimin, prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen (sipas rastit) të ashtuquajtura turbina me gaz të Serisë MGT, Serinë THM, Serinë PT8, Serinë S (bashkërisht *Turbinat e Gazit*) duke përfshirë biznesin pas shitjeve për këto Turbina Gazi (bashkërisht Biznesi i turbinave të gazit).

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i turbinave me gaz dhe tregu i shërbimeve pas shitjes për turbinat me gaz, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të vetëm nga shoqëria CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co.,Ltd mbi asetet e Biznesit të turbinave me gaz të MAN Energy Solutions SE.

CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co., Ltd dhe filialet e saj, Guanghan Gas Turbine GmbH dhe Guanghan Gas Turbine Schweiz AG, janë aktive në prodhimin dhe shitjen e turbinave me gaz dhe ofrimin e shërbimeve teknike për turbinat me gaz, komponentët dhe pajisjet/sistemet ndihmëse përkatëse.

CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co., Ltd një filial i China State Shipbuilding Co. Ltd, nuk ka gjeneruar të ardhura dhe nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri

Biznesi Target nuk është prezent dhe nuk ka realizuar të ardhura në Shqipëri gjatë vitit 2022.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm nga shoqëria CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co., Ltd mbi asetet e Biznesit të turbinave me gaz të MAN Energy Solutions SE.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS


Leida MATJA

()
Zv/Kryetar


Rezana KONOMI

()
Anëtar

Adriana BERBERI

()
Anëtar

Durim KRAJA

()
Anëtar

Denar BİBA

()
Kryetar

REPUBLICA E SHQIPËRISE
AUTORITETI I KONKURRENCËS